



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 17.10.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndërtim i fushes së futbollit në Katund të Ri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime ndërtimi 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 66,638,078.13 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e tetë pikë trembëdhjetë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.286, datë 18/09/2025, me Nr.10969 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumentet sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.286, datë 18/09/2025, me Nr.10969 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë.13.4.2023, p,r “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 66,638,078.13 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e tetë pikë trembëdhjetë) Lek pa TVSH.

Projekti do financohet në dy vite të ndarë, për vitin 2025 dhe 2026 nga buxheti i bashkisë.

Afati i realizimit të punimeve është, 200 (dyqind) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 1 vit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, neni 43, pika 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjes të deklarimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për

Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare: (2022, 2023, 2024), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Ky kriter është konceptuar dhe përcaktuar në përputhje me: Nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili autorizon autoritetet kontraktore të përcaktojnë kritere për përvojën teknike që lidhen me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës që prokurohet; Nenin 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të*

Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku jepen kufijtë maksimalë të vlefshmërisë së kriterëve që lidhen me përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomikë. Sipas kësaj dispozite, autoriteti kontraktor mund të kërkojë: a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës, realizuar gjatë pesë viteve të fundit; b) Punë të ngjashme me vlerë monetare totale jo më të madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Dispozita e mësipërme nuk vendos një detyrim për të përdorur vlerat maksimale, por vendos kufij të sipërm. Pra, vlerat e përdorura në këtë kriter janë në përputhje me dispozitat ligjore, sepse nuk i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar, por vendosen brenda tyre, në kufirin maksimal të lejuar. Duke qenë se objekti i kësaj kontrate “Ndërtim i fushës së futbollit në Katund të Ri” përfshin: përfshin një sërë punimesh ndërtimore, infrastrukturore dhe teknike që kërkojnë njohuri dhe përvojë specifike në fushën e ndërtimit të ambienteve sportive. Ky lloj objekti përfshin ndërhyrje në shtresat e terrenit, sistemin e bazamentit, ndërtimin e sistemit të ndriçimit, vendosjen e ndarjeve, drenazhimit dhe elementeve ndihmëse të infrastrukturës sportive. Për këtë arsye, kërkesa për përvojë të mëparshme në punë të ngjashme, në vlera të përafërta me fondin limit të kësaj kontrate, është një mekanizëm i arsyeshëm për të garantuar se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike, organizative dhe financiare të nevojshme për ta realizuar me sukses projektin. Në këtë kuptim, përcaktimi që një operator mund të kualifikohet nëse plotëson njërin prej dy kushteve (një kontratë me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit ose një total kontratash me vlerë jo më të vogël se dyfishi i fondit limit) siguron konkurrencë të drejtë dhe të hapur ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke mos krijuar barriera të panevojshme, por duke ruajtur kriterin e aftësisë reale për zbatimin e kontratës. Prandaj, ky kriter është ligjërisht i bazuar, proporcional me objektin dhe qëllimin e procedurës, dhe në përputhje të plotë me parimet themelore të Ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021, që kërkojnë siguri për zbatimin cilësor të kontratës, konkurrencë të ndershme dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë. Ky kriter siguron AK që operatorët që kualifikohen të kenë: Eksperiencë në përballimin e kontratave të përmasave dhe natyrës së ngjashme; Aftësi organizative dhe teknike për të realizuar kontratën në cilësinë, afatin dhe buxhetin e kërkuar. Garanci për konkurrencë dhe proporcionalitet. Kriteri është hartuar në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, duke lejuar dy alternativa për plotësimin e përvojës; Pa favorizuar një segment të caktuar të tregut, por duke siguruar që cilido operator me përvojë reale dhe të dokumentuar në kontrata të ngjashme, të ketë mundësi reale për kualifikim; Duke mos e tejkaluar kufirin maksimal të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, por duke e përdorur atë në funksion të natyrës së veçantë të objektit të kontratës. Ai është hartuar për të garantuar që kontrata do të realizohet nga një operator që ka kapacitetin real për ta përballuar me sukses, duke shmangur kualifikimin e operatorëve pa përvojë të ngjashme ose joadekuate për nivelin e kompleksitetit të punës.

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP-2 A Ndërtime civile dhe industrial.
- NP-4 A Rruge, autostrada mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP-7 A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit..
- NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve.
- NS-2 A Punime hidrosanitare....
- NS-4 A Punime rifiniture, murature
- NS-8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
- NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj
- NS-18 A Punime topogjeodezike.
- NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive

NP-1A	Punime gjermimi në tokë.	Gjermim dheu me ekskavator zinxhir, 0.25 m ² , në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet Gjermim dheu me ekskavator zinxhir 0.15 m ² , në kanale gjeresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet (për kanale e drenazhit dhe plintat e profileve të methinit)	0-20 mln leke (8,697,645 LEKE)
NP-2A	Ndërtime civile dhe industriale	Themel betoni C16/20 F.V Konstrukione metalike te perbera per tribunen Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m Soletë monolite C20/25 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm Struktura te holla monolite betoni C 20/25 Mbushje me cakell poshte plintit Beton C12/15 posht plintave Beton C-20/25 (Me cakell) Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m Soletë monolite C20/25 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm F.V Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20cm F.V Beton C-16/20 (Me zall) F.V Beton C25/30 për depon F.V Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm	0-20 mln leke (16,290,022 LEKE)
NP-4A	Rruge, autostrada mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Rulim i tabanit të fushës me rul 17 ton Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri Gjeotekstil me gramature 180 g/m ² Shtrese granili me granulometri 8-15 mm, perhapur e ngjeshur me makineri,t=10cm Shtrese granili me granulometri 4-8 mm, perhapur dhe ngjeshur me makineri,t=10cm Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri, Shtrese granili i imet	0-20 mln leke (16,153,100 LEKE)

NP-7A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi evaditje	F.V. tuba të brinjëzuar drenazhi HDPE Ø 110 mm (brenda në fushë, çdo 7m) F.V. tuba të brinjëzuar drenazhi HDPE Ø 200 mm (në perimetrin e fushës) Mbushje me granil lumi 10mm përreth tubave të drenazhit Pusete shkarkimi b/a 80 x 80 cm, h=150cm Ndërtim pusete kontrolli b/a, 1x1x2 m në kapak gize F.V. tuba shkarkimi të brinjëzuar HDPE SN8 Ø-315 mm (për kolektorin kryesor), Kunetë 19x15x100 cm, marka e betonit 250 me zgarë 2.5x15x100 cm, klasi A15, Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize Struktura te holla monolite betoni C 20/25 F.V. Tuba b/a Ø 1500 mm, Tubo korrugato 40mm Tubo korrugato 63mm F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086, Mbushje me zhavorr pas mureve Ndertim drenazhi, mbushje me zhavorr + PVC 200 mm Tubacion PVC Ø50 për hyrje/dalje uji + kllapa + gypa PPR.	0-20 mln leke (4,043,013LEKE)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 3.0 km, Furnizim me rere te lare lumi t=15 cm, e perzier me 10-15 % torfe	0-20 mln leke (8,897,436LEKE)
NS-1A	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje mur blloqe betoni Prishje shtresa betoni	0-20 mln leke (317,690LEKE)
NS-2A	Impiante hidro- sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.V. Rezervuari zingato 5000 litra F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, Pn 10 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25 F.V. Elektropompe uji 1.5kw q=60l/min h=35 m me bombul 50 l F.V. Hidrante Ø 50 mm F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm Termoizolim tubi Ø 1/2" me armofleks (d22x9) F.V. Kolektor shpendares 3/4" (5+5) F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110 F.V. Tuba e rakorderi PVC F.V. Bolier 100 l F.V. WC allafrenga F.V. Lavaman porcelani	0-20 mln leke (621,326 LEKE)

		F.V. Tub xingato dhe rakorderi ~ 1 " F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90 F.V. Tub PVC Ø 200mm F.V. Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, Pn 10 Valvola njëkahëshe + nyje lidhëse në dalje Instalimi i pompës, lidhjeve elektrike dhe hidraulike	
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 Suvatim me llaç-çimento Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Shtrese pllaka mermeri 2cm Shtrese me pllaka porcelanat Veshje me pllake majolike Plintuse pllake grez Dritare d/alumini dyfi xh. Dyer d/alumini me mbushje element d/a. F.V. Pilete grumbulluese shume dalje Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	0-20 mln leke (3,094,033LEKE)
NS-8A	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.	Grope septike 6 m3 Mure betoni i parapergatitur dekorativ 2 ane, lyer me boje rezine per rrethimin e jashtem.	0-20 mln leke (5,194,092 LEKE)
NS-14A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende) Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A Automat Mag-Termik 16-20A 2P-220V F.V. Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A Llampe sinjalizimi 220V;1.2w Tub shllang Ø 32-36mm Tub shllang Ø 14-17mm Tub shllang Ø 22-26mm F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2 Çelsa nje polar 10A 280V komplet F.V kuti suport pllaket 2 modular Priza shuko universale Komplet F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T	0-20 mln leke (1,129,929 LEKE)

		Ndricues Katror LED 50w , 4000-6000K,3200lm, 600*600mm Ndricues katror LED me 18w , 4000K,1800lm, Percielles tokezimi 1*10mm2 Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m Panelet elektrike sipas skemes ne projekte IP67 Pompë zhytëse 3kW/4HP, 230V, 75 m Hmax, 6-8 m³/h Panel elektrik me mbrojtje termike, kondensator dhe automatik ON/OFF Kabëll elektrik 3x4mm² i izoluar për nën ujë	
N.S-18A	Punime topogjeodezike.	Punime ne vendosje e tubacionit te drenazhit , piketim dhe kontroll te fushes se futbollit, dhomave te zhveshjes dhe murit rrethues	0-20 mln leke
NS-20A	Shpime gjeologjike, punime inxhinierike, puse e shpime për ujë.	Shpim pusi me thellësi 75 m me diameter Ø250 (në terren mesatar - argjilë/ranor) F.V. Tuba metalik D=219mm Tub PVC Ø140 mm për mbështjellje (tip shpuese) Tub PVC Ø140 mm me vrima për filtrim uji (10 m fundi) Rërë silikate për filtrim (rreth tubit) Vulë me çimento bentoniti (në kokë pusi) Test prodhimi uji dhe analizë laboratorike	0-20 mln leke (1,129,929 LEKE)

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi në Infrastrukturë. | 1 (një) |
| b. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| c. Inxhinier Gjeodet | 1 (një) |
| d. Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| e. Inxhinier Elketrik | 1 (një) |
| f. Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |

Lidhur me stafin e mësipërm inxhinierik, çdo ofertues duhet të disponojë, si dhe duhet të paraqesë në tender, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht: Kontratën e punës të vlefshme, diplomën përkatëse, si dhe listpagesat sipas periudhës së kërkuar më sipër, si dhe duhet

detyrimisht të figurojnë në listpagesat respektive për tre muajt e fundit, sipas kodeve përkatëse të punësimit. (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, mjedisi, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licencës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licencës, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi në Infrastrukturë	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore dhe infrastrukture të fushes, referuar preventivit të punimeve (Punime ndërtimi, Germimi, Prishje), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-2, NP-4 NS-1, NS-4, NS-8
1 (nje) Inxhinier Hidroteknik	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Hidrosanitare, Kanalizime, të cilave i korrespondon kategoria NS-2 dhe NP-7
1 (nje) Inxhinier Mjedisi	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Mjedisore, referuar në preventivin e punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP12.
1 (nje) Inxhinier Elektrik	Eshtë përgjegjës për punimet e rrjetit të brendshëm elektrik dhe telefonise, të cilave i korrespondon kategoria NS-14.
1 (nje) Inxhinier Gjeodet	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit në ndërtimet e reja që do të kryhen, të cilave i korrespondon kategoria NS-18.
1 (nje) Inxhinier Gjeolog	Eshtë përgjegjës për punimet ndërtimit të pusit, të cilave i korrespondon kategoria NS-20.

Shënim: Bazuar në Rekomandimin Nr.6732, datë 21.10.2020 ”Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”, inxhinierët e mësipërm duhet të vetdeklarojnë se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, konkretisht:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës specialist që të disponojë certifikatë e trajnimit si "Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier". Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: Diplomë/certifikatë, Kontratë Pune të vlefshme.

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës Mbikëqyrës teknik i certifikuar– Përgjegjës për kontrollin e cilësisë, përputhshmërinë dhe testet finale të fushës sipas standardeve FIFA/iATS. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: Diplomë/certifikatë, që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione të njohura nderkombetare Mbikëqyrës teknik i certifikuar (Certified Supervisor), sipas standardeve FIFA/iATS, Kontratë Pune të vlefshme.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualit teknik të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"

bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

a. Është kërkuar Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos ne kete kontrate ku dhe numuri i punojesve te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: "Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes."

b. Është kërkuar Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar dhe ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Ky ekspert është i domosdoshëm për të evituar ndodhjen e cdo shtate të paparashikuar si dhe mbrojtjen nga zjarri. Vlerësojme se kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", ku përcaktohet se personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.

c. Është kërkuar Mbikëqyrës teknik i certifikuar (Certified Supervisor) – Përgjegjës për kontrollin e cilësisë, përputhshmërinë dhe testet finale të fushës", është përgjegjës për monitorimin e të gjitha proceseve të punës në fushën sportive, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, verifikimin e përputhshmërisë me standardet e FSHF/UEFA/FIFA, si dhe organizimin dhe mbikëqyrjen e testeve finale të fushës (testet e barit natyral ose sintetik, sistemit të vaditjes, ndriçimit dhe infrastrukturës ndihmëse). Ky rol garanton që fusha të dorëzohet në përputhje me specifikimet teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- 1(nje) punonjës Teknik Ndërtimi

- 1(nje) punonjës Teknik Topograf
- 1(nje) punonjës Asfaltoshtrues
- 2 (dy) punonjës Hidraulikë
- 2 (dy) punonjës Elektracist
- 2 (dy) punonjës Karpentier
- 2 (dy) punonjës Hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës Hidroizolues
- 1(nje) punonjës Bojaxhi
- 2 (dy) punonjës Saldator
- 2 (dy) punonjës Murator
- 1 (nje) punonjës Pllakashtrues
- 3 (tre) punonjës Shofer Kamioni
- 10 (dhjete) Punëtores ndertimi te thjeshte.

Punonjës Manovrator

- 2 (dy) Eskavatorist
- 1(nje) Automakinist

Për keta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- certifikate të sigurimit teknik të lëshuar nga shoqëritë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për punonjësit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certifikate të aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

Për punonjësit Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë të manovratorëve bazohet në Urdhërin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

(Në rastin kur punonjësit shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

- Për punonjësit e krahut , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës të vlefshme .

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse të lëshuara nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar

me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Tekniku i ndërtimit është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic jane germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kerkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes. Tekniku duhet te disponoje Diplome e shkolles mesme.

Tekniku topograf është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit ne ndertimet e reja qe do te kryhen duke asistuar drejtuesin teknik. Tekniku duhet te disponoje Diplome e shkolles mesme.

Asfaltoshtrues është i nevojshem për realizimin e punimeve te shtresave asfaltike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku volumi i punimeve te jashteme. Asfaltoshtrues duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Hidrauliku është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku volumi me i madh i punimeve hidraulike ne ndertese dhe ne punimet e jashteme . Hidrauliku duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Elektricisti është i nevojshem për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku volumi me i madh i punimeve elektrike.Elektricisti duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Karpentierët janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave te preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore te themelit, bejne vendosjen e modinave per kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese per fazen e betonimit te mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metalit si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elemetëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Karpentierët duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Hekurkthyesit janë të nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve te hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Hekurkthyesi duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Hidroizolues janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave te preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimevedhe volumit te punimeve. Hidroizolues duhet te disponoje Certifikate Trajnimi / Diplome.

Muratori është i nevojshëm për realizimin e punimeve te muraturës, soletave etj. sipas zërave të preventivit. Bëjnë piketimin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas

specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dymave dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashëve me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbuturues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura. Numri i kërkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Muratori duhet të disponojë Certifikatë Trajnimi / Diplome.

Pllakashtrues janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kërkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Pllakashtruesi duhet të disponojë Certifikatë Trajnimi / Diplome.

Bojaxhijt janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bëjnë stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjtave, të strukturave metalike, kornizave të hekurtave të ndërtesave. Numri i kërkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. Bojaxhijt duhet të disponojë Certifikatë Trajnimi / Diplome.

Saldator janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit të konstruksioneve të perbera të rrethimit dhe tribunes se fushes.

Shoferi është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kërkuar është bazuar te grafiku i punimeve dhe volumit të punimeve. **Shoferi** duhet të disponojë leje për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina.

Manovratori eskavatorist është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si eskavator germimi dhe fadroma të të gjitha llojeve, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmise të Aftësisë Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator germimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

Manovratori automakinist është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës

percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-**autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve** u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST**.

Punëtorët e thjeshtë të ndërtimit janë të nevojshëm për realizimin e detyrave fizike dhe mbështetëse në ndërtimin e fushes së futbollit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 44 persona, në listpagesa sipas formularëve standard për sigurimet, për 3 muajt e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumente të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve, përfshin punëtorë të thjeshtë, persona janë stafi i kualifikuar inxhinierëve, person teknikë, person specializuar/të kualifikuar dhe person manovratorë/shofere të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve si edhe kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve të punës dhe grafikut të punimeve. Referuar VKM nr.216 datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/makinerive/pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasi
1	Eskavator me zinxhir min 18 ton	Pronesi ose me qera	2 cope
2	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	Pronesi ose me qera	1 cope
3	Minieskavator me zinxhir	Pronesi ose me qera	1 cope
4	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	Pronesi ose me qera	1 cope
5	Mini fadrome	Pronesi ose me qera	1 cope
6	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
7	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-18 ton	Pronesi ose me qera	5 cope
8	Kamiocine kapacitet 3.5-5 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
9	Kamion me vinxh me kapacitet 5-10 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
10	Autobot Uji min 5000 liter	Pronesi ose me qera	1 cope
11	Autosondë Hidraulike e tipit Top-Driver me rrotullim per shim pus uji me kapacitet ngrites min 40 ton.	Pronesi ose me qera	1 cope
12	Vinç 4m, me shpejtësi të ngritjes jo më pak se 2.8m/min, dhe shpejtësi motori 3kw.	Pronesi ose me qera	1 cope
13	Makineri për punë në hapsira të vogla, me gjerësi deri në 10cm me 100 cm, të pajisur me lopatë të përparme.	Pronesi ose me qera	1 cope
14	Makineri germimi dhe ngjeshjeje, për punë në hapsira të ngushta, me gjerësi deri në 15cm me 90 cm.	Pronesi ose me qera	1 cope
15	Grejder (mjet teknologjik)	Pronesi ose me qera	1 cope
16	Rrule gjeshës me peshe 7-10 ton	Pronesi ose me qera	2 cope
17	Rrule gjeshës me peshe 15 ton	Pronesi ose me qera	1 cope
18	Asfaltoshtruese	Pronesi ose me qera	1 cope
19	Autobitumetrice	Pronesi ose me qera	1 cope
20	Autobetoniere	Pronesi ose me qera	2 copë
21	Autopompë betoni	Pronesi ose me qera	1 copë
22	Betoniere kantieri 0.25-0.5 m3	Pronesi ose me qera	1 copë
23	Autobetoniere kantieri me kapacitet mbajtes deri 2.5m3	Pronesi ose me qera	2 copë
24	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	Pronesi ose me qera	1 cope
25	Motogjenerator	Pronesi ose me qera	1 copë
26	Vibrator betoni thellesie	Pronesi ose me qera	2 copë
27	Skeleri	Pronesi ose me qera	500m2
28	Betoforma	Pronesi ose me qera	500 m2
29	Paisje topografike Totalstation/GPS	Pronesi ose me qera	1 cope
30	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	Pronesi ose me qera	1 cope
	Rimorkiator per transport mjetesh me kapacitet mbajttese jo me te vogel se 50 ton + Koke terheqese	Pronesi ose me qera	1 cope

- Pajisje te tjera ndihmese, (te cilat duhet te vertetohen me deklarate sipas shtojces perkatese, te DST:

Nr	Mjete mbrojtese	Njesia	Sasia
1	Kuti e ndihmes se shpejte	cope	1 copë
2	Tabela sinjalistike ne kantier	cope	10 copë
3	Helmeta pune, kokore	cope	40 copë
4	Jelek pune fosforeshent	cope	40 copë

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- *Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- *Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.*
- *Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Për te gjithë mjetet dhe pajisjet e kërkuara te shoqërohen me foto.*

Shënim: Për mjetin “Rimorkiator për transportin e makinerive”, në rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni çertifikate pronësie / kontratë qeraje, nga autoriteti kontraktor do të pranohet edhe dokumenti kontratë huapërdorje.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaroon se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto

sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 te ndryshuar parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kerkohet që operatorët ekonomike t’i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njësi është bazuar tek zerat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkojnë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të vepres.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomikë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

- Mjetet kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina janë kërkuar për transportin e dherave apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për transportimin e tubacioneve dhe rakorderive që do të furnizohen me qëllim realizimin e vepres.

Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina me kapacitet mbajtës të ndryshëm. Ky numër është i nevojshëm në raport edhe me vëllimin e materialeve.

- Mjetet eskavator me goma, minieskavator, makineri germimi për hapsira të ngushta, fadroma, eskavator me zinxhir, janë kërkuar për punimet si gërmime kanalesh, gërmim sistemi drenazhit, gërmime dheu, sistemime, etj gjatë zbatimit të projekt preventivit.

Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gërmimeve të dheut, nevojitet përdorimi i eskavatorëve dhe minieskavatorëve për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet.

- *Autobetoniere, betoniere, autopome betoni, janë kërkuar për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me betonin dhe beton arme me qëllim ruajtjen e markës së betonit sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se transportimi i betonit, kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv, janë kërkuar këto mjete.*
- *Mjetet Grejder (mjet teknologjik), Rrule gjeshës ,Asfaltoshtuese dhe Autobitumetrice, Autobot uji do të përdoret në momentet e ndërtimit të shtresave të ndryshme që do të realizohen në kantierin e veprës. Kjo makineri është e domosdoshme për të siguruar zbatimin e shtresave dhe neshtresave të objektit sipas specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit.*
- *Paisjet Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndërtimit, Motogjenerator, Vibrator betoni thellesie, Skeleri, Betoforma, Totalstation/GPS do përdoren për punime të ndryshme në objekt sipas projekt preventiv. Këto paisje janë të domosdoshme gjatë zbatimit të projektit në kohë dhe me cilesi.*
- *Ndërsa mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”*

Nr	Lloji i Makinerive	Argumentimi
1	Eskavator me zinxhir min 18 ton	<i>Eshtë i nevojshëm për germim në trupin e fushës dhe hedhjen e materialeve në mjete transportuese</i>
2	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	<i>Eshtë i nevojshëm për hapjen e kanaleve dhe germime të ndryshme në kantier</i>
3	Minieskavator me zinxhir	<i>Eshtë i nevojshëm për hapjen e themele dhe germime të ndryshme në kantier</i>
4	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	<i>Eshtë i nevojshëm për hapje kanalesh dhe hedhjen e materialeve në mjete transportuese</i>
5	Mini fadrome	<i>Eshtë i nevojshëm për ngarkimin e materialeve të ndryshme në kamioncinë, dhe spostimin e materialeve të ndryshme në rrugë</i>
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	<i>Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme të dalë nga gërmimet apo materialet që do importohen në objekt</i>
7	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-18 ton	<i>Eshtë i nevojshëm për transportin e materialeve të ndryshme të dalë nga gërmimet apo materialet që do importohen në objekt</i>

8	Kamiocine kapacitet 3.5-5 ton	<i>Eshte i nevojshem per transportin e materialeve te ndryshme dhe transport punonjesish</i>
9	Kamion me vinxh me kapacitet 5-10 ton	<i>Eshte i nevojshem per ngritje materiale te ndryshme ne kantier</i>
10	Autobot Uji min 5000 liter	<i>Eshte i nevojshem per te pasur uje per procese te ndryshme gjate punimeve</i>
11	Autosondë Hidraulike e tipit Top-Driver me rrotullim per shim pus uji me kapacitet ngrites min 40 ton.	<i>Eshte i nevojshem per shpimin e pusit</i>
12	Vinç 4m, me shpejtësi të ngritjes jo më pak se 2.8m/min, dhe shpejtësi motori 3kw.	<i>Eshte i nevojshem per ngritje materiale te ndryshme ne kantier si konstruksionet e perbera per ndertimin e rrethimit tef ushes apo dhe te tribunës</i>
13	Makineri për punë në hapsira të vogla, me gjerësi deri në 10cm me 100 cm, të pajisur me lopatë të përparme.	<i>Eshte i nevojshem per hapjen e kanaleve te drebazheve</i>
14	Makineri germimi dhe ngjeshjeje, për punë në hapsira të ngushta, me gjerësi deri në 15cm me 90 cm.	<i>Eshte i nevojshem per hapjen e kanaleve te drebazheve</i>
15	Grejder (mjet teknologjik)	<i>Eshte i nevojshem per hapjen e materialeve si cakull e stabilizantit ne trupin e fushes</i>
16	Rrule gjeshës me peshe 7-10 ton	<i>Eshte i nevojshem per ngjeshjen e binderit dhe asfaltit</i>
17	Rrule gjeshës me peshe 15 ton	<i>Eshte i nevojshem per ngjeshjen e stabilizantit</i>
18	Asfaltoshtruese	<i>Eshte i nevojshem per shtrimin e binderit dhe asfaltit</i>
19	Autobitumetrice	<i>Eshte i nevojshem per shtrimin e prajmerit</i>
20	Autobetoniere	<i>Eshte i nevojshem per transportin dhe betonit ne objekt</i>
21	Autopompë betoni	<i>Eshte i nevojshem per hedhjen dhe betonit ne objekt</i>
22	Betoniere kantieri 0.25-0.5 m3	<i>Eshte i nevojshem per pergatitjen e pergatitjen e llacit per suvatim</i>
23	Autobetoniere kantieri me kapacitet mbajtes deri 2.5m3	<i>Eshte i nevojshem per pergatitjen dhe betonit ne sasira te vogela ne objekt</i>
24	Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndertimit	<i>Eshte i nevojshem per pergatitjene hekurit dhe kthimin e hekurit ne objekt</i>
25	Motogjenerator	<i>Eshte i nevojshem per saldimet ne kantier dhe per te siguruar energji elektrike ne objekt</i>
26	Vibrator betoni thellesie	<i>Eshte i nevojshem per vibrimin e betonit</i>

27	Skeleri	<i>Eshte i nevojshem per krijimin e skelave dhe punimet ne lartesi</i>
28	Armature / betofroma	<i>Eshte i nevojshem per krijimin e armaturave te ndryshme</i>
29	Paisje topografike Totalstation/GPS	<i>Eshte i nevojshem per matjet dhe piketimet e objektit</i>
30	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	<i>Eshte i nevojshem per ndertimin e zyles se personelit ne kantier.</i>
	Rimorkiator per transport mjeteshe me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 50 ton + Koke terheqese	<i>Eshte i nevojshem per transportin e mjeteve ne kantier</i>

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçense lëshuar nga QKL: “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”, “Kodi III.2.B”, së bashku me aktin e miratimit.

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu.), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, prishje (mur tulle, shtresa etj.), dhe kryerjen e transportit të tyre në vend depozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë liçencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licensimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- Certifikat: ISO 9001/2015 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për

personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b. Certifikat: ISO 45001 : 2018/2023 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

- c. Certifikat: ISO 14001:2015-“Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.

Argumentimi: *ISO 14001:2015 është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatore për mbrojtjen e mjedisit. Kjo certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.*

2.4.3 Për Listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- Pompe zhytëse, Panel kontrolli dhe Sensori i nivelit.
- Tubacione polietileni drenazhi

Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve (në katalog të vendoset një shenjë e veçantë për të gjitha të dhënat e kërkuara në specifikimet teknike), ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatat e cilesise ISO 9001: 2015 të prodhuesit/ve ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i artikujve të kërkuar, duhet të paraqesë dokumentin që vërteton lidhjen midis prodhuesit ose distributorit. Në rastin e paraqitjes së dokumentit që tregon lidhjen midis ofertuesit-distributorit, OE duhet të paraqes dokumentet e lidhjes midis distributorit dhe prodhuesit, dokumenti duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontrates. Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.4.4 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoritetikontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallurfituese

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore të Kreut III, të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku parashikohet:

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit të prokurimit publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit të prokurimit publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit të prokurimit publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

2.4.5 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”

Grupi i hartimit të specifikimeve referuar të dhënave teknike në projektin e hartuar nga projektuesi ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 200 (dyqind) ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

Grupi i specifikimit kërkon kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, nenin 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë perberese e strukture së Bashkisë Durrës, që ka hartuar edhe projektin ide të zbatimit duke qënë elemente perberes të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatese të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Vendim i KM nr. 448, datë 31.7.2025 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit" si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore". Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive. Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”. Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në specifikimet teknike, AK i është referuar standardeve ndërkombëtare EN, fakti që ekzistojnë standard ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, vlerësojmë që për standardet e mësipërme, ne si AK pranojmë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo

asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Shënim: Në çdo kërkesë te preventivit ku është shenuar marka e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetare të njësise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit